

**AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE**

**PËRGJIGJET E KËRKESAVE TË TESTIT**

**(SKEMA E VLERËSIMIT)**

**Shkolla e mesme social- kulturore (artistike, koreografike, sportive).**

*Sesioni I, 9 qershor 2008*

**Varianti A**

*Udhëzime të përgjithshme:*

- Testi përbëhet nga dy pjesë: një poezi dhe një prozë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me alternativa dhe 12 me zhvillim.
- Skema parashikon mundësitë e përgjigjeve.
- Skema tregon specifikimet për secilën pikë në të njëjtën pyetje.
- Në pyetjet me disa mundësi është e rëndësishme që nxënësi të thotë të paktën një të paktën një prej mundësive.
- Vlerësimi i pyetjes 12, është specifikuar me kujdes, duke pasur parasysh që është një pyetje ese.
- Skema nuk konsiderohet përfundimtare. Kjo do të thotë që për pyetje të caktuara nxënësi mund të sjellë përgjigje të cilat nuk janë parashikuar në skemë, por gjejnë kuptim në përputhje me pyetjen dhe logjikën e saj
- Saktësia gjuhësore ndikon në vlerësimin e nxënësit, kur ka përsëritje të theksuara gabimesh, ose gabime të cilat prishin kuptimin e shprehjes.

*Skema e përgjigjeve:*

**Pjesa e I            Bukuria**

<b>Pyetja 1</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 2</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 3</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 4</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 5</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 6</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>

**Pyetja 7            1 pikë**

Do të pranohen të gjitha përgjigjet që dalin nga kuptimi i poezisë.  
**0 pikë.** Nëse jep një titull që nuk ka lidhje me kuptimin e poezisë.

**Pyetja 8            3 pikë**

**Fjalët kyçe: Bukuria, perëndia, gjithësia, kudo, shtrihem, vdekja etj.**  
**2 pikë**            Kur jep dy fjalë kyçe, ose kur jep tre, por pa rend kronologjik.  
**1 pikë**            Kur jep një fjalë kyçe.  
**0 pikë**            Kur nuk jep asnjë fjalë kyçe.

**Pyetja 9      2 pikë**

Pyetja retorike është: Pse të dua paskam faj? Ka funksion të dyfishtë.

- Ajo **ndihmon** në kuptimin e konceptit mbi dashurinë. Kjo e tregon poetin të **pafajshëm**, kur adhuron të bukurën, dashurinë, gruan.
- Jep **përruljen** e poetit ndaj objektit të adhuruar.
- Njeriu nuk mund ta **shmangë** ndjenjën e tij.
- Ajo ka edhe funksionin e drejtpërdrejt artistik, me anë të të cilit, krijohet **një pauzë**, pas përshkrimit që poeti bën mbi të bukurën dhe dashurinë. Ajo jep **idenë e distancës**.

**1 pikë** Nëse jep një shpjegim ku të dalë vetëm një funksion, por pak të qartë.

**0 pikë** Nëse nuk kuptohet asgjë nga shpjegimi.

**Pyetja 10      2 pikë.**

**10/a** - Kuptim i figurshëm.

**10/b** - Poeti ka përjetim specifik. Fjala shije përcjell përjetimin në brendësi të njeriut për të bukurën. Vetë shija është proces i brendshëm, që realizohet jo me dëgjim dhe shikim, por me ndijim.

**1 pikë.** Nëse nxënësi jep njërin nga përgjigjet.

**0 pikë.** Nëse përgjigja nuk përshtatet me kërkesat.

**Pyetja 11      4 pikë**

- Këmba e saj
- Puthja
- Naimi platonik( e sheh nga distanca, e adhuron, e sheh si të krijuar nga perëndia, delikate)
- Naimi panteist( i sheh të shkrirë bashkë: Zotin, bukurinë, dashurinë, kudo; në qiej, në hënë, ndër pyj etj)

**3 pikë** nëse nxënësi jep elementët erotikë dhe shpjegon vetëm një anë të filozofisë së tij, ose jep një element erotik dhe shpjegon dy tiparet e filozofisë.

**2 pikë.** Kur jep vetëm dy përgjigje.

**1 pikë.** Kur jep vetëm një përgjigje.

**0 pikë.** Kur i jep të gabuara dhe të pakuptueshme.

**Pyetja 12      8 pikë**

**12/a** **Shtjellimi i idesë 2 pikë . Duhet të kihen parasysh:**

- Fokusimi në temë, përshatja me qëllimin e temës..
- Të përshkruajë objektin.
- Të tregojë vlerat e tij
- Të përcjellë një mesazh nëpërmjet përshkrimit.

**1 pikë** Nëse nxënësi përshkruan mirë objektin, por nuk përcjell mesazh.

**0 pikë** Kur nuk përshkruan asgjë, ose kur ajo që shkruan nuk ka kuptim.

**12/b Organizimi dhe struktura 2 pikë . Duhet të kihet parasysh:**

- Pjesët përbërëse( hyrje, zhvillim, mbyllje).
- Kronologjia( rend të mendimit dhe ideve, të shembujve që jep).
- Logjika( të ketë lidhje me çfarë është thënë më parë).
- Kalimet e kuptimshme ( nga fjala te objekti).

**1 pikë.** Kur respekton vetëm strukturën e krijimit

**0 pikë.** Kur struktura nuk të jep asnjë kuptim.

**12/c Stili dhe origjinaliteti . 2 pikë. Duhet të kihet parasysh:**

- Shprehjet origjinale ( figuracioni, fjalë jo të zhargonit të përditshëm).
- Nëse stili është i gjallë, tërheqës, ndikues. (me rrjedhshmëri , të ketë efekt)
- I qartë.
- Jo imitues,( të mbështetet te autori, por të japë dhe mendimin e tij.

**1 pikë.** Kur thotë diçka të vetën, por pa larmi, pa bukuri, pa shumë qartësi.

**0 pikë.** Kur nuk thotë asgjë, ose nuk kuptohet asgjë nga ajo që ka thënë.

**12/d Saktësia gjuhësore( sintaksa dhe drejtshkrimi) 2 pikë Duhet të kihet parasysh:**

- Trajta e duhur e fjalëve.
- Fjali të sakta.
- Shenjat e pikësimit.
- Shkronja e madhe.

**1 pikë.** Kur ka gabime, por kuptohet se çfarë ka shkruar

**0 pikë.** Kur gabimet e shumta deformojnë ose nuk lejojnë kuptimin e shprehjes.

**Pjesa e dytë Evgjeni Grande**

**Pyetja 13 A 1 pikë**

**Pyetja 14 D 1 pikë**

**Pyetja 15 C 1 pikë**

**Pyetja 16 A 1 pikë**

**Pyetja 17 B 1 pikë**

**Pyetja 18 C 1 pikë**

**Pyetja 19 C 1 pikë**

**Pyetja 20 3 pikë**

Shtëpia e Evgjenisë nuk dukej e përshtatshme për të pritur mikun;

**Detajet:** e zhveshur, pa shije pa elegancë.

**2 pikë** Kur cilëson si ishte shtëpia dhe jep vetëm një detaj, ose jep vetëm dy detajet pa koment.

**1 pikë.** Nëse nxënësi jep vetëm detajet, ose vetëm koment.

**0 pikë.** Nëse nxënësi nuk jep asnjërin nga përgjigjet.

**Pyetja 21 4 pikë pikë****Në fjalitë e ndërtuara të dalin këto tipare:****21/a.** Hijeshia dhe femëria.**21/b.** Ndjenja e dashurisë, butësia, lumturia.**21/c.** Ndrojtja, turpi.**21/d.** Padjallëzia, sinqeriteti, mirësia.**3 pikë** Kur jep tre fjali të sakta.**2 pikë** Kur jep dy fjali të sakta.**1 pikë** Kur jep një fjali të saktë.**0 pikë** Kur nuk jep asnjërën.**Pyetja 22 3 pikë****22/a** Proliksiteti dhe përshkrimi.**22/b** Tipizimi dhe detajimi.**22/c** Realizmi ose vërtetësia.**2 pikë** Kur jep dy nga tiparet.**0 pikë** Kur jep vetëm një nga tiparet.**0 pikë** Kur nuk jep asnjë nga tiparet.**Pyetja 23 3 pikë****23/a** Do më shikojë, do më marrë në konsideratë, etj**23/b** Vlerëson veten, mendjemadh, bie në sy etj.**23/c** I shtohet inati, mllefi, etj**2 pikë.** Kur shpjegon dy nga shprehjet.**1 pikë.** Kur shpjegon një të një nga shprehjet.**0 pikë.** Kur nuk shpjegon asnjërën.**Pyetja 24 1 pikë**

Janë emra abstraktë .

**0 pikë.** Kur nuk jep këtë përgjigje.**Pyetja 25 3 pikë**

- Shprehja është marrë nga fragmenti dhe ka kuptimin: Që sytë të njeriut, shprehin atë që të ndjen zemra. Gjithçka që ndjen pasqyrohet në fytyrë.

- Tiparet që i jep njeriut ky pasqyrim janë: dëlirësia, sinqeriteti, kuptueshmëria, thjeshtësia (referuar edhe Evgjenisë).

- Nxënësi mund të shkruajë gjatë komentit edhe shprehje të përafërta nga kuptimi ose mund të marrë shembuj për t'iu referuar kuptimit.

**2 pikë.** Kur nxënësi jep vetëm një kuptim për thënien dhe një argument pse ai e kupton ashtu, por të formuluar mirë.**1 pikë.** Jep dobët kuptimin mbi shprehjen pa ilustrim dhe pa argument.**0 pikë.** Kur shpjegimi është i paqartë dhe i palexueshëm.